



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2018:045185

Datë: 24.08.2018

Numri i dokumentit: 00105697

**PKR.nr.64/18**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA**

Departamenti për Krime të Rënda, me kryetarin e trupit gjykues Skender Çoçaj, me procesmbajtësen Birsën Kume - sekretare juridike pranë kësaj gjykate, në lëndën penale kundër të akuzuarve J. Q., R. D. që të dy nga Republika e Shqipërisë dhe K. K., nga Prizreni, për shkak të veprave penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge në bashkëkryerje nga neni 273 paragrafi 1 të Kodit Penal, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prizren PP/I.nr.107/18 të datës 17.08.2018, në seancën e shqyrtimit fillestarë pas shqyrtimit të marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë PP/I.nr.107/18 të datës 17.08.2018, në prezencën e Prokurorit të Shtetit Metush Biraj, të akuzuarve dhe mbrojtësve të tyre av.A. Sh., Av.B. Gj. dhe av.B. K., me datë 23.08.2018, mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 24.08.2018 përpiloi këtë:

**A K T G J Y K I M**

**Të akuzuarit:**

**1.J. Q.**, nga i F. dhe e ëma T., e gjinisë K., i lindur me datë *data e lindjes...*, në B. tani me vendbanim në D. Republika e Shqipërisë, RR..., pn, i martuar –baba i dy fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme, me profesion ndihmës kuzhinieri, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Shqipërisë.

**2.R. D.**, nga i ati Dh., dhe e ëma A., e gjinisë M., i lindur me *data e lindjes...* në Sh. të Republikës së Shqipërisë, tani me banim në T. në rrugën ... kati i ..., banesa nr..., i pamartuar, ka të kryer liceun artistik T., i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Shqipërisë.

**3.K. K.**, nga i ati B. dhe e ëma N., e lindur B., i lindur me *data e lindjes...*, në Prizren, ku edhe tani jeton, në rrugën .. nr..., ka të kryer shkollën e mesme, i papunë, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

**JANË FAJTOR**

### **1. I akuzuari J. Q.**

Sepse pa autorizim ka poseduar me qëllim të shitjes apo shpërndarjes, substanca apo preparate të cilat janë shpallur me Ligji si narkotik, substanca psikotrope apo analoge, në atë mënyrë që me datë 10.08.2018 rreth orës 03:00 në rrugën ... në njërin prej tendave turistike të vendosura për festivalin e filmit dokumentar të metrazhit të shkurtë “Doku-Fest” në parkun e lagjes në Prizren, ku ishte së bashku me të pandehurit R. D. e K. K. dhe me A. S. dhe E. M., kishte të fshehur një qese të vogël ku brenda saj kishte narkotik, të llojit “Kokainë” në peshë rreth 1.65 gr, një qese plastike me substancë të narkotikut, të llojit “ekstazi” prej 149 copë, një peshore të vogël dhe një pjatë të llamarinës e destinuar për marrjen e narkotikut të llojit “kokainë”.

-Këso dore kanë kryer veprën penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 par.1 të KPRK.

### **2. I akuzuari R. D.**

Sepse pa autorizim ka poseduar me qëllim të shitjes apo shpërndarjes substanca apo preparate të cilat janë shpallur me ligj si narkotikë, substanca psikotrope apo substanca analoge, në atë mënyrë që afër vendit të ngjarjes në kohë të njejtë të përshkruar më afërsisht sikurse në pikën një të dispozitivit në xhepin e majtë ka mbajtur dy qese me narkotik, të llojit “marihuanë” në peshë rreth 46.27 gram, dhe një tabletë me substancë të narkotikut, të llojit “ekstazi” me ngjyrë të kuqe.

-Këso dore kanë kryer veprën penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 par.1 të KPRK.

### **3. I akuzuari K. K.**

Sepse pa autorizim ka poseduar me qëllim shitje ose shpërndarje substanca apo preparate të cilat janë shpallur me ligj si narkotik, substanca psikotrope apo analoge, në atë mënyrë që në vend dhe kohë të njejtë të përshkruar me afërsisht sikurse në pikën një të dispozitivit, në trup ka pas të fshehur një qese të mbushur me narkotik të llojit “marihunë” në peshë rreth 3.40 gram.

-Këso dore kanë kryer veprën penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 par.1 të KPRK.

Andaj gjykata në bazë të dispozitivit të lartshënuar 4, 7, 41, 42, 43, 45, 46, 47, 73 dhe nenit 273 paragr.1 të KP-së, të akuzuarit i:

## **G J Y K O N**

**1. Të akuzuarin J. Q.,** me dënim me gjobë në lartësi prej 1000 (njëmijë) euro dhe,

-Dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve,

Në pajtim me dispozitat e nenit 47 të KP me pëlqimin e të akuzuarit.

Dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve i zëvendësohet në dënim me gjobë në lartësi prej 1200 (njëmijë e dyqind) euro dhe,

Në kuptim të nenit 80 të akuzuarit i shqiptohet

### **DËNIMI UNIK**

Me gjobë në lartësi prej 2.200 (dymijë e dyqind) euro në të cilin dënim do ti llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim nga data 10.08.2018 deri më datën 23.08.2018, ashtu që për çdo ditë të kaluar në paraburgim do ti llogaritet 20 euro ndërsa pjesën tjetër të gjobës i akuzuari është i obliguar ta paguaj në afat prej 15 ditësh pas plotëfuqishmërisë së aktgjykimit.

Nëse i akuzuari nuk mundet apo nuk dëshiron të paguaj gjobën dënimi me gjobë do ti zëvendësohet me dënim me burgim.

**2. Të akuzuarin R. D.**, me dënim me gjobë në lartësi prej 500 (pesëqind) euro dhe,

-Dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 5 (pesë) muajve,

Në pajtim me dispozitat e nenit 47 të KP me pëlqimin e të akuzuarit.

Dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 5 (pesë) muajve, i zëvendësohet në dënim me gjobë në lartësi prej euro 700 (shtatëqind) eurove.

Në kuptim të nenit 80 të akuzuarit i shqiptohet

### **DËNIMI UNIK**

Me gjobë në lartësi prej 1200 (njëmijë e dyqind) eurove në të cilin dënim do ti llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim nga data 10.08.2018 deri më datën 23.08.2018, ashtu që për çdo ditë të kaluar në paraburgim do ti llogaritet 20 euro ndërsa pjesën tjetër të gjobës i akuzuari është i obliguar ta paguaj në afat prej 15 ditësh pas plotëfuqishmërisë së aktgjykimit.

Nëse i akuzuari nuk mundet apo nuk dëshiron të paguaj gjobën dënimi me gjobë do ti zëvendësohet me dënim me burgim.

**3. Të akuzuarin K. K.**, me dënim me gjobë në lartësi prej 200 (dyqind) euro dhe,

-Dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 5 (pesë) muajve,

Në pajtim me dispozitat e nenit 47 të KP me pëlqimin e të akuzuarit.

Dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 5 (pesë) muajve i zëvendësohet në dënim me gjobë në lartësi prej euro 500 (pesëqind) eurove.

Në kuptim të nenit 80 të akuzuarit i shqiptohet

## DËNIMI UNIK

Me gjobë në lartësi prej 700 (shtatëqind) euro në të cilin dënim do ti llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim nga data 10.08.2018 deri më datën 23.08.2018, ashtu që për çdo ditë të kaluar në paraburgim do ti llogaritet 20 euro ndërsa pjesën tjetër të gjobës i akuzuari është i obliguar ta paguaj në afat prej 15 ditësh pas plotëfuqishmërisë së aktgjykimit.

Nëse i akuzuari nuk mundet apo nuk dëshiron të paguaj gjobën dënimi me gjobë do ti zëvendësohet me dënim me burgim.

Në kuptim të nenit 275 paragrafi 3 KPP

Të akuzuarit J. Q. i konfiskohet narkotiku i llojit “Kokainë” në peshë rreth 1.65 gr, një qese plastike me substancë të narkotikut, të llojit “ekstrazi” prej 149 copë, një peshore të vogël dhe një pjatë të llamarinës e destinuar për marrjen e narkotikut të llojit “kokainë”,

Të akuzuarit R. D. i konfiskohet : dy qese me narkotik, e dyshuar të llojit “marihuanë” në peshë rreth 46.27 gram, dhe një tabletë me substancë të narkotikut, të llojit “ekstazi” me ngjyrë të kuqe, si dhe

Të akuzuarit K. K. ti konfiskohet një qese narkotik të llojit “marihuanë” .

Obligohen të akuzuarit që të paguajnë shpenzimet e procedurës në lartësi secili prej nga 50 (pesëdhjetë) euro, si dhe nga 50 (pesëdhjetë) euro në emër të Fondin për kompenzimin e viktimave të krimit, krejt këto në afat prej 15 ditësh pas plotëfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm.

## A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prizren ka paraqitur aktakuzën PP/I.nr.107/18 të datës 17.08.2018, kundër të akuzuarve J. Q., R. D. dhe K. K., për shkak të veprave penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge në bashkëkryerje nga neni 273 paragrafi 1 të Kodit Penal, si dhe marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë Prizren – PP/I nr.12/2018 të datës 09.02.2018.

Prokurori i shtetit gjatë seancës për shqyrtimin e marrëveshjes për pranimin e fajësisë ka deklaruar se marrëveshja për pranimin e fajësisë ndaj të akuzuarve J. Q., R. D. dhe K. K. është arritur në përputhje me kushtet e parapara me ligj, ku të pandehurit nuk kanë qenë të kushtëzuar në asnjë formë dhe në mënyrë të kundërligjshme plotësisht kanë qenë të vetëdijshëm për pasojat dhe veprimet e tyre në momentin e aktit të pranimit të fajësisë sipas marrëveshjes, marrëveshjen e kanë nënshkruar pas konsultimit me mbrojtësit e tyre, prandaj duke marrë parasysh faktin se të pandehurit edhe në seancë e kanë pranuar fajësinë sipas marrëveshjes për pranim të fajësisë, gjykatës i ka propozuar që të njejtëve të u shqiptohet sanksioni përkatës në kuadër të marrëveshjes së arritur.

Mbrojtësi i të akuzuarit J. Q. Av. A. Sh. gjatë seancës ka deklaruar se pas konsultave me të mbrojturin e tij, pa ndikim nga askush dhe bindjes së lirë të tij i njejtë në vetëdije dhe pa presion duke shikuar edhe lehtësimet e pranimit të fajësisë ku i pandehuri edhe e ka dhënë

nënshkrimin e marrëveshjes. I mbrojturi i tij për herë të parë ka hasur ndesh me ligjet e R.Kosovës dhe ndien keqardhje, andaj ka kërkuar nga gjykata që të ketë në konsideratë që pasi të pranojë marrëveshjen e lidhur me Prokurorinë Themelore tek shqiptimi i gjobave të merren si rrethanë lehtësuese gjendjen ekonomike të dobët familjare ndaj të pandehurit J. Q., dhe të aprovojë marrëveshjen e pranimit të fajësisë sikurse që është lidhur me Prokurorinë Themelore Departamenti për krime të rënda në Prizren.

Mbrojtësi i të akuzuarit R. D. Av. B. Gj. gjatë seancës ka deklaruar se pas negocimit të marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë i mbrojturi i tij R. D. ka pranuar fajësinë për akuzën për të cilën akuzohet, pranimi i fajësisë është bërë në mënyrë vullnetare pa ndonjë shtrëngim dhe i propozon gjykatës që pas marrëveshjes të i shqiptohet denimi me gjobë sipas kushteve ekonomike i të pandehurit.

Mbrojtësi i të akuzuarit K. K. Av. B. K. gjatë seancës ka deklaruar se i mbrojturi i saj K. K. pas njoftimit me veprën penale e cila i vihet në barrë si dhe negocimit respektivisht kushteve të negocimit për pranimin e fajësisë i njejtë vullnetarisht e ka pranuar fajësinë, njiherit ka shpreh edhe pendim për veprën në fjalë duke premtuar se kjo është hera e fundit që ka ra ndesh me ligjin, i njejtë është i gjendjes së dobët materiale, jeton vetëm me nënën e cila vuan nga diabetit i tipit A, gjendjen materiale të vështirë, andaj ka proppozuar që gjykata sipas mundësisë pas pranimit të marrëveshjes t ia mundësojë pagesën e dënimit me gjobë me këste, gjithashtu propozon ndërprerjen e paraburgimit.

Të akuzuarit J. Q., R. D. dhe K. K., gjatë seancës së dëgjimit kanë deklaruar se e pranojnë fajësinë sipas marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë për veprat penale për të cilat janë akuzuar dhe se në tërësi janë pajtuar me fjalët të dhënë nga mbrojtësit e tyre.

Gjykata nën kushtet dhe rrethanat e marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

Sa i përket gjendjes faktike, gjykata ka vërtetuar ashtu si është përshkruar në dispozitivin e aktakuzës në kushtet dhe rrethanat e marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë, kështu që gjykata në tërësi ka vërtetuar se

I akuzuari J. Q. pa autorizim ka poseduar me qëllim të shitjes apo shpërndarjes, substanca apo preparate të cilat janë shpallur me Ligji si narkotik, substanca psikotrope apo analoge, në atë mënyrë që me datë 10.08.2018 rreth orës 03:00 në rrugën ... në njërin prej tendave turistike të vendosura për festivalin e filmit dokumentar të metrazhit të shkurtë “Doku-Fest” në parkun e lagjes në Prizren, ku ishte së bashku me të pandehurit R. D. e K. K. dhe me A. S. dhe E. M., kishte të fshehur një qese të vogël ku brenda saj kishte narkotik, të llojit “Kokainë” në peshë rreth 1.65 gr, një qese plastike me substancë të narkotikut, të llojit “ekstazi” prej 149 copë, një peshore të vogël dhe një pjatë të llamarinës e destinuar për marrjen e narkotikut të llojit “kokainë”.

- Se i akuzuari R. D.

Pa autorizim ka poseduar me qëllim të shitjes apo shpërndarjes substanca apo preparate të cilat janë shpallur me ligj si narkotikë, substanca psikotrope apo substanca analoge, në atë mënyrë që afër vendit të ngjarjes në kohë të njejtë të përshkruar më afërsisht sikurse në pikën

një të dispozitivit në xhepin e majtë ka mbajtur dy qese me narkotik, të llojit “marihuanë” në peshë rreth 46.27 gram, dhe një tabletë me substancë të narkotikut, të llojit “ekstazi” me ngjyrë të kuqe.

-Se i akuzuari K. K.

Sepse pa autorizim ka poseduar me qëllim shitje ose shpërndarje substanca apo preparate të cilat janë shpallur me ligj si narkotik, substanca psikotrope apo analoge, nëatë mënyrë që në vend dhe kohë të njejtë të përshkruar me afërsisht sikurse në pikën një të dispozitivit, në trup ka pas të fshehur një qese të mbushur me narkotik të llojit “marihunë” në peshë rreth 3.40 gram.

Pas dëgjimit të pikëpamjeve të prokurorit të shtetit, si dhe të akuzuarve lidhur me marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë, gjykata konstatoi se të akuzuarit kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga të akuzuarit pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësit e tyre, gjykata ka konstatuar se të akuzuarit në asnjë mënyrë nuk kanë qenë të detyruar ose të shtrënguar ta pranojnë fajësinë, se pranimi i fajësisë mbështetet në fakte dhe prova materiale të rastit konkret të cilat janë paraqitur në aktakuzë të pranuar edhe nga të akuzuarit dhe se nuk ekzistojnë asnjë nga rrethanat që parashihen në dispozitat e nenit 253 paragrafi 1 dhe 2 të KPP-së për hudhjen e aktakuzës, prandaj edhe ka vendosur që ta pranojë marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë.

Lidhur me dënimin prokurori i shtetit ka qëndruar pranë dënimit të propozuar në marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë.

Të akuzuarit dhe mbrojtësit e tyre lidhur me dënimin kanë deklaruar se qëndrojnë pranë dënimit të propozuar në marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë.

Gjykata nga të cekurat më lartë ka ardhur në përfundim se në veprimet e të akuzuarve formohen të gjitha elementet e qenies së veprave penale të përshkruar si në shqiptim të këtij aktgjykimi dhe për këtë ka vendosur që të akuzuarit ti shpall fajtor dhe ti gjykoj në bazë të ligjit, e më parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tij.

Gjatë marrjes së vendimit mbi llojin dhe lartësinë e dënimit gjykata ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese të parapara si në nenin 73 të KPP të cilët ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit, gjashtu gjykata në rastin konkret duke pas parasysh se të akuzuarit kanë arritur marrëveshje për pranimin e fajësisë aplikoi dispozitat e nenit 75 paragrafi 1 nënparagrafi 1.3 të KP, ashtu që si rrethanë posaçërisht lehtësuese gjykata mori pranimin e fajësisë sipas marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë, gjykata ka vlerësuar rrethanat personale të akuzuarve, gjendjen e tyre të dobët ekonomike, dhe faktin se është hera e parë që të njejtë kanë ra ndesh me ligjin, se në gjykim kanë pasur qëndrim tejet korrekt. Kështu që duke mos gjetur rrethana rënduese gjykata ka ardhur në përfundim se me dënimin e shqiptuar si në diapozitiv të këtij aktgjykimi, do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij nga neni 41 i KP dhe ky dënim i tillë i shqiptuar sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprat penale të kryera dhe me rrethanat personale të cilat i posedojnë të akuzuarit dhe se me këtë dënim të akuzuarit do të parandalohen nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe do të bëhet rehabilitimi i tyre, e gjithashtu do të parandalohen edhe personat tjerë nga kryerja e veprave penale.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është marrë konform nenit 450, dhe 453 paragrafi 1 të KPP-së.

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN  
DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA ,**

**2018:045185, 24.08.2018**

Procesmbajtësja  
Birsen Kume

Kryetari i trupit gjykues  
Skender Çoçaj

**UDHËZIM JURIDIK:** Pasi që palët pas shpalljes së aktgjykimit kanë deklaruar se hekin dorë nga ankesa për bazat ligjore për të cilat kanë të drejtë, atëherë ky aktgjykim është i plotfuqishëm me ditën e shpalljes me datë 23.08.2018.